

20140130330

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SHËRBIME AUDIO DHE
AUDIOVIZUELE MEDIATIKE

Neni 1

Në Ligjin për shërbime audio dhe audiovizuele mediatike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 185/13), në nenin 2 pas alinesë 1 shtohet aline e re 2, si vijon:

" - promovim të lirisë së shprehjes,".

Alinetë 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 bëhen aline 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12.

Neni 2

Në nenin 6 pas alinesë 1 shtohet aline e re 2, si vijon:

"- e nxit lirinë e shprehjes,".

Alinetë 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15 dhe 16 bëhen aline 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16 dhe 17.

Neni 3

Në nenin 14 paragrafi (2) alineja 1 ndryshohet si vijon:

"- të dyja shoqatat e gazetarëve të Republikës së Maqedonisë me numër më të madh të anëtarëve propozojnë nga një anëtar të Këshillit,".

Alineja 4 shlyhet.

Alinetë 5 dhe 6 bëhen aline 4 dhe 5.

Në paragrafin (4) numrat "1, 2, 3 dhe 4" zëvendësohen me numrat "1, 2 dhe 3".

Në paragrafin (11) në fjalinë e parë fjalët: "e përcakton shoqatën shumicë" zëvendësohen me fjalët: "i përcakton shoqatat".

Neni 4

Në nenin 21 pas paragrafit (5) shtohet paragraf i ri (6), si vijon:

"(6) Vendimi nga paragrafi (3) i këtij neni është përfundimtar, e kundër të njëjtit mund të parashtrohet padi në gjykatën kompetente, në pajtim me ligjin."

Neni 5

Në nenin 29 paragrafi (1) fjalët: "dhe të publikimeve elektronike" dhe numrat "7" dhe "10" shlyhen.

Neni 6

Në nenin 48 pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2), si vijon:

"(2) Ndalimet e posaçme nga paragrafi (1) i këtij neni duhet të jenë në pajtim me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut."

Neni 7

Në nenin 152 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"Kuvendi i Republikës së Maqedonisë do t'u dërgojë thirrje publike për dorëzim të propozimit të kandidateve për anëtarë të Këshillit të Agjencisë, në pajtim me nenin 14 të këtij ligji, në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji."

Në paragrafin (9) pika në fund të fjalisë zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: "ndërsa deri në ditën e hyrjes në fuqi të akteve, do të zbatohen aktet që kanë vlejtur deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji."

Neni 8

Në nenin 153 paragrafi (9) pika në fund të fjalisë zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: "ndërsa deri në ditën e hyrjes në fuqi të akteve, do të zbatohen aktet në fuqi deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji."

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e ardhshme nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".